



#EENCanHelp


EEN Albania
NetLife
NEWS FOR NETWORK PARTNERS

1. Java Europiane e SME-ve

Instituti shqiptar i SME-ve organizoi aktivitetin me temë "Java e SME-ve, Tiranë 2019, transformimi i ekonomisë sonë". Ky aktivitet, kishte për qëllim të bënte bashkë aktorët kryesorë, publikë dhe privatë, në fushën e biznesit, të cilët nëpërmjet instrumentave të ndryshëm financiarë dhe teknikë, mbështesin zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme shqiptare.

Aktiviteti u organizua në kuadër edhe të Javës Europiane të SME-ve, e cila synon të ndihmojë sipërmarrësit ekzistues si dhe Start Up, të gjejnë informacion mbi mbështetjen në dispozicion dhe të përpiqen të inkurajojnë më shumë njerëz për të filluar një sipërmarrje të re.

Një nga instrumentat e rëndësishëm që u prezantua për bizneset në këtë aktivitet nga stafi i AIDA-s dhe EEN-Albania, ishte Rrjeti European i Ndërmarrjeve, me shërbimet që ai ofron për mbështetjen dhe rritjen e biznesit, si dhe programi COSME, si një mjet i rëndësishëm financiar dhe teknik për të mundur zgjerimin e tregut të biznesit drejt tregut unik European, drejt përfaqjes në inovacion, teknologji të reja dhe kërkim zhvillimin.



2. Takim B2B “Shqipëri – Serbi”

Ajencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) në cilësinë e Koordinatorës së Rrjetit Europian të Ndërmarrjeve (EEN-Albania), në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë Serbe, organizuan takimet B2B (Business to Business) ndërmjet kompanive shqiptare dhe serbe.

Ky event ndërmjetësimi dedikuar “Misionit të Biznesit Shqipëri-Serbi” u organizua në ambientet e Pallatit të Kongreseve në kuadër të Panairit Ndërkombëtar të Tiranës me partneritet Klik Ekspo Group dhe përfshiu takimet e biznesit të planifikuara sipas interesave dhe qëllimeve për të gjetur partnerë ndërkombëtarë.

Pjesë e eventit ishin kompani serbe dhe shqiptare, operuese në sektorë të ndryshëm si agroindustri, metal, plastikë, paketim, tekstile, automotive etj., të cilat zhvilluan takime bilaterale B2B me qëllim identifikimin e mundësive potenciale për bashkëpunim ndërkombëtar, rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve dhe shërbimeve për tu bërë pjesë e rrjetit në nivel rajonal dhe më gjerë, si edhe krijimin e marrëveshjeve afatgjata, me fokus eksport - importin.





Happy Holidays

and Best Wishes for
2020!



een.ec.europa.eu
#EENCanHelp

Vizitoni:

www.een.al

een.ec.europa.eu

